

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, kryesuese e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin sa vijon:

Lidhur me vlerësimin e pasurisë

1. Për sa i përket blerjeve të disa pasurie të paluajtshme dhe konfliktit të interesit

- blerje të tokës me sip. 4.560 m², në R, Vlorë, blerë në vitin 2012, në shumën 273.600 lekë;
- blerje të tokës me sip. 4.300 m², në R, Vlorë, blerë në vitin 2012, në shumën 258.000 lekë;
- blerje të tokës me sip. 1.000 m², në R, Vlorë, blerë në vitin 2010, në shumën 60.000 lekë;
- blerje të tokës me sip. 3.200 m², në R, Vlorë, blerë në vitin 2010, në shumën 320.000 lekë;
- blerje të tokës me sip. 2.500 m², në R, Vlorë, blerë në vitin 2010, në shumën 150.000 lekë.

Rezultoi se në të gjitha transaksionet e shitblerjes, shitësit e këtyre pasurive të paluajtshme kanë nënshkruar akt përfaqësimi, duke deklaruar përfaqësimin e tyre nga bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit, z. S.G, dhe duke specifikuar në përmbajtjen e akteve të përfaqësimit se vlera e pasurive u shlye nga z. S.G, pa specifikuar shumën e paguar.

Hartimi i kontratave të shitblerjes për blerjen e këtyre pasurive të paluajtshme mes shitësve të pasurive dhe bashkëshortit të subjektit, me çmim blerjeje në vlerat e mësipërme, disa herë më të vogla se vlerat minimale të tregut, u krye pasi shitësit e pasurisë deklaruan se vlera e pasurive është shlyer nga shtetasi S.G dhe ato nuk kishin më pretendime, fakt ky i konfirmuar edhe nga subjekti, gjatë hetimit dhe në seancën dëgjimore.

Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti i motrës lidhur me këto pasuri të paluajtshme, kishte qëllim ushtrimin e një aktiviteti tregtar, gjendet i pabesueshëm, për sa rezultoi se ai nuk hartoi kontrata blerje por akte përfaqësimi, dhe se në të paktën një rast akti i përfaqësimit të shitësve me bashkëshortin e motrës së subjektit, z. S.G, dhe kontrata e shitblerjes së shitësve me bashkëshortin e subjektit, u kryen në një ditë para të njëjtit noter.

Kontratat e shitblerjes të hartuara mes shitësve të pasurive me bashkëshortin e subjektit, rezultojnë se janë afektuar me kryerjen e veprimeve juridike të pashpjegueshme në kontekstin ligjor të qarkullimit civil të sendeve, duke shmangur deklarimin e vlerës së plotë të paguar për të përfituar lidhur me pasuritë e paluajtshme, dhe duke deformuar të vërtetën. Kjo situatë, lidhur me vlerën e përfitimit të këtyre pasurive, e vendos subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

Në kuptim të nenit 5, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, dhe të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me konfliktin e interesit me shitësit e këtyre pasurive, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, duke gjykuar çështje me palë shitësit e pasurive dhe duke mos referuar në kërkesën e dorëheqjes rrethanat e plota lidhur me marrëdhënien me karakter pasuror mes shitësve të pasurive dhe bashkëshortit të saj, është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të shkronjës “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për sa i përket pasurive të tjera të deklaruara dhe burimit të krijimit

Rezulton se subjekti i rivlerësimit nga data 8.2.1996 deri më 12.1.2002 ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, funksion që vijon ta ushtrojë nga data 28.2.2009 e aktualisht. Referuar situatës konkrete të subjektit të rivlerësimit, dhe

jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në këto periudha kohore dhe ndërmjet tyre, janë si vijon:

- Apartament banimi, me sip. 111.6 m², (120.7 m²), lagjja “****”, Vlorë, blerë më 3.5.2006. Burimi i krijimit: të ardhura nga aktiviteti si ristorator i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklaruases. Vlera: 60.000 euro.
- Depozitë në Credins Bank, krijuar më 9.6.2008 e në vazhdim. Burimi i krijimit: të ardhura nga aktiviteti si ristorator i bashkëshortit, aktiviteti si avokate i deklaruases, ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 16.7.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Strasburgut datë 7.12.2010. Vlera: 3.939.019,99 lekë.
- Automjet tip “Daimler Chrysler C270 CDI”, blerë më 24.6.2009. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera gjatë viteve, të cilat i janë dhënë hua shtetases E.G në vitin 2008, kthyer në vitin 2009. Vlera: 9.100 euro. Detyrimi doganor: 479.000 lekë.
- Depozitë në Credins Bank, krijuar në datën 20.7.2016. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara gjatë viteve të emigracionit, lënë në administrim shtetasit M.V dhe kthyer prej këtij të fundit. Vlera: 9.004,38 euro. Pjesa takuese: 100%.
- Llogari rrjedhëse në Credins Bank, krijuar në datën 23.1.2017. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara gjatë viteve të emigracionit, lënë në administrim shtetasit M.V dhe kthyer prej këtij të fundit. Vlera: 1.887.300 lekë.
- Likuiditet *cash* në shumat 52.000 euro dhe 100.000 lekë, të vjedhura në datën 4.8.2016. Burimi i krijimit: të ardhurat nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004. Vlerat: 52.000 euro dhe 100.000 lekë.
- Likuiditete *cash* (shuma e mbetur pas vjedhjes së banesës në datën 4.8.2016). Burimi i krijimit: të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004. Vlera: 10.000 euro.

Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës: “*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri e ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*”.

Nga analizimi i burimeve të krijimit të pasurive të mësipërme, rezulton se:

2.1 Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga avokatia, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* të përfituara gjatë periudhës 2004 – 2009, në shumën neto 6.000.000 lekë.

QKB-ja konfirmon se shtetasja Mirela Mishgjoni figuron e regjistruar si person fizik me NUIS ***, më 9.5.2007, deri në vitin 2011 kur çregjistrohet lidhur me aktivitetin privat si avokate.

Për rrjedhojë, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga avokatia, nga viti 2004 deri në datën 9.5.2007, nuk provohen për sa i përket ligjshmërisë së tyre, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore, ndaj ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e pasurive, të deklaruara me këtë burim krijimi.

2.2 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti restorant gjatë periudhës 2005 – 2011, deklaruar në deklaratën *Vetting*, në shumën rreth 5.400.000 lekë.

Subjekti, lidhur me të ardhurat e deklaruara në shumën rreth 5.400.000 lekë gjatë periudhës 2005 – 2011, sa i përket këtij aktiviteti, nuk provon se ato kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, pasi ato janë jo vetëm të paprovuara se janë përfituar lidhur me kohën e shumën, por edhe të panënshtruara pagimit të detyrimeve tatimore, ndaj këto të ardhura nuk duhen konsideruar si të ardhura që plotësojnë standardin kushtetues e ligjor të të ardhurës së ligjshme për efekt të këtij procesi e, për pasojë, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

Padia civile gjatë procesit dhe në funksion të hetimit administrativ, nuk e çliron subjektin dhe personin e lidhur nga përgjegjësitë dhe nuk i kthen të ardhurat e pretenduara në të ligjshme për qëllim të këtij procesi.

2.3 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga shitja e restorantit në Itali

Referuar certifikimit në gjuhën italiane, lëshuar nga noteri L.Z në datën 15.6.2006, i papërkthyer në gjuhën shqipe, nga i cili rezulton:

Palët pjesëmarrëse në këtë certifikim janë: pala e parë, shtetasit V.B dhe B.V në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërisë “****” S.N.C.; pala e dytë, shtetasi V.D në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “****”; pala e tretë, shtetasit SH.Y, ZH.L, ZH.Y e X.Y si përfaqësues i shoqërisë “****”.

Palët kanë marrëdhënie juridike mes tyre si vijon: pala e tretë ka rënë dakord që t’i shesë palës së parë sipas aktit noterial nr. *** rep., datë 30.9.2002, shoqërinë e tyre të cilën e kanë pasur në pronësi, me aktivitet restorant, në shumën 87.798 euro, e cila është shlyer nga pala e parë deri në datën 5.3.2004. Pala e parë me këtë dokument pranon që shoqërinë e tyre ta shesin tek pala e dytë, në shumën totale 135.000 euro, nga e cila 41.573 euro për klientelën e krijuar në vite dhe 93.427 euro për pajisjet.

Në vlerësim të dokumentacionit ligjor të mësipërm, si dhe deklarimit të të ardhurave të përfituara nga ana e bashkëshortit të subjektit, rezulton se nuk provohet jo vetëm burimi i krijimit të përdorur për shumën rreth 87.798 euro për blerjen e shoqërisë “****” nga shoqëria “****”, por nuk provohet me dokumentacion ligjor provues pagimi i detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj shoqërie, si dhe pjesa takuese e pretenduar e bashkëshortit të subjektit, ndaj këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

2.4 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga transaksionet e shitblerjes së automjeteve

2.4.1 Për sa i përket transaksioneve shitje/blerje të automjetit tip “Daimler Chrysler”, blerë më 22.1.2008, në shumën 500.000 lekë dhe shitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, më 8.7.2010, në shumën 900.000 lekë.

Nga hetimi nuk u provua mundësia financiare e subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme në vitin 2008. Përveç kësaj, shitja e automjetit pas 2 viteve në qarkullim, në një vlerë rreth 2 herë më të lartë se çmimi i blerjes, pas afro 2 vitesh nga momenti i blerjes, nuk krijon bindjen mbi vlerën e plotë të përfituar nga ky transaksion shitblerjeje automjeti, ndaj këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

2.4.2 Për sa i përket blerjes së automjetit tip “Daimler Chrysler”, në datën 24.6.2009, në vlerën 9.100 euro, dhe pagimit detyrim doganor në vlerën 479.000 lekë. Burimi i krijimit i deklaruar: të ardhura të kursyera gjatë viteve, të cilat i janë dhënë hua shtetases E.G në vitin 2008, motrës së subjektit, hua që deklarohet se është kthyer prej saj në vitin 2009.

Nga analiza e deklaratës noteriale nr. ***, datë 2.3.2015, nënshkruar nga subjekti dhe motra e saj, ku deklarohet se shuma 17.000 euro, e dhënë hua nga subjekti në datën 12.7.2008, është likuiduar nga motra e saj në qershor të vitit 2009, rezultoi se kjo deklaratë është hartuar në vitin 2015, kohë kur është mbajtur procesverbali në ILDKPKI mes subjektit dhe inspektorit të këtij institucioni, 6 vite pas kthimit të pretenduar të huas, duke krijuar bindjen se është hartuar me qëllim mbulimin me të ardhura të ligjshme të pasurisë së luajtshme gjatë kontrollit nga ILDKPKI-ja.

Në deklarinimin e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar kthim huaje nga motra e saj. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese, duke u dhënë të gjitha deklarinimeve vlerën e provës, deklarinimi i vitit 2009 i cili ka vlerën e provës në këtë proces, nuk provon pretendimin e subjektit mbi kthimin e huas prej motrës së saj në vitin 2009, ndaj kjo hua nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare.

Në analizë të qëndrimeve lidhur me burimet e mësipërme dhe duke mbajtur në konsideratë se subjekti ka kryer funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga data 8.2.1996 deri më 12.1.2002 dhe nga data 28.2.2009 e aktualisht, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, bazuar në sa më sipër arsyetuar, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Mirela Mishgjoni, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ajo nuk ka arritur nivel të besueshëm, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e deklarinimit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kuptim të shkronjave “b” “ç” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE
Kryesuese (kundër)